REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 4848 REP
NR. 2737 KOL

## MARREVESHJE SIGURUESE

Sot me date 18/12 2015, para meje noterit _M. Sadushaj_, anetar i Dhomes se Notereve, Tirane, u paraqiten Palet:

A)

1. BARREDHENES: **Alban Jaho,** lindur ne Tirane me 31.05.1969, me leternjoftim nr.028702781 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar;

2. BARREDHENES: **Sara Hoxha**, lindur ne Tirane me 18.01.1996, me pasaporte nr.BB8082266 dhe banues ne Tirane, e cila perfaqesohet plotesisht nga Znj. Vjollca Hoxha sipas prokures nr. 1153 Rep Nr.480 Kol date 20.03.2014;

3. BARREDHENES: **Itan Hoxha**, lindur ne Rome, me 04.04.2007, me pasaporte nr.BB 8082282 dhe banues ne Tirane i cili perfaqesohet plotesisht nga Znj. Vjollca Hoxha ne baze te nenin 232 dhe 233 te Ligjit nr 9062 per Kodin e Familjes;

4. BARREDHENES: **Redia Hoxha**, lindur ne Tirane me 15.02.1998, me pasaporte nr. BB 8082295 dhe banues neTirane, e cila perfaqesohet plotesisht nga Znj. Vjollca Hoxha ne baze te nenin 232 dhe 233 te Ligjit nr 9062 per Kodin e Familjes;

5. BARREDHENES: **Enkelejdi Joti**, lindur ne Tirane me 11.10.1969, me leternjoftim nr.027731539 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar

6. BARREDHENES: **"DEM Capital"** me seli ne Tirane perfaqesuar nga **Petraq Shomo**, lindur ne Tirane me 07.01.1963, me leternjoftim nr.024962367 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar;

7.BARREDHENES: **Eduart Poda**, lindur ne Tirane me 02.07.1968, me leternjoftim nr.025074744 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar

8. BARREDHENES: **E & E Investment,** me seli ne Tirane, perfaqesuar nga Arben Taipi lindur ne Tirane me 01.04.1965, me leternjoftimin nr.028622358 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar;

9. BARREDHENES: Shoqeria **"Union Distribucion Servis Albania" sh.p.k** me seli ne Tirane, perfaqesuar nga **Ilir KARAGUNI,** madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Secili me vete referuar si "Barredhenes" e se bashku referuar si "Barredhenesit"

B)

1. BARREMARRES: **Samir Mane**, lindur ne Korce me 24.12.1967, me leternjoftim me numer 030866691 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

2. BARREMARRES: **Agim Zeqo** lindur ne Korce me 26.08.1969, me pasaporte me numer personal G 80026036H dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

3. BARREMARRES: **Alba Gina**, lindur ne Lushnje me 1977, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar;

4. BARREMARRES: **"Aiba Kompani" sh.a** me seli ne Durres, me numer nipti J 61818528 J perfaqesuar nga **Erjon Hoxhaj,** madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Ne prezence edhe te:

- **Lorela Hoxha**, lindur ne Tirane me 19.10.1993, me pasaporte nr. BB 8082279 dhe banues ne Tirane, e cila perfaqesohet plotesisht nga Znj. Vjollca Hoxha ne baze te prokures nr.3364 RepNr.706 Kol date 22.11.2011;
- **Vjollca Hoxha**, lindur ne Tirane me 23.03.1969, me leternjoftim nr.027970614 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Palët bien dakord të hartojnë këtë marreveshje me kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

*DEKLARIME PARAPRAKE*

a.Barredhenesit jane zoterues te aksioneve ne kapitalin e Shoqerise DigitAlb SH.A.
b.Me date 18/12/2015, palet kane lidhur ndermjet tyre nje shtojce "Ndryshime ne Marreveshjen Kuader te Shitblerjes se Aksioneve te Supersport" (ne vijim referuar "Marreveshja Kuader "). Barredhenesit kane marre persiper nje sere detyrimesh ne Marreveshjen Kuader, e ndryshuar me date 18/12/2015.
c.Per te siguruar permbushjen e detyrimeve te Digitalb dhe Barredhenesve ndaj Barremarresit ne baze te Marreveshjes Kuader dhe pagesen e plote te shumes se siperpermendur, Barredhenesit bien dakord te vendose ne favor te Barremaresit nje barre siguruese ne **16 %** te aksioneve ne zoterim tek Digitalb, me nje vlere nominale prej **36,811.160** leke, ne perputhje me dispozitat e kushtet e kesaj marreveshje.

**1. Neni 1-Objekti**
Me ane te kesaj marreveshje secili prej 9 prej Barredhenesve vendos ne favor te Barremarresit nje barre siguruese te aksioneve ne masen e percaktuar ne Deklarimeve paraprale ne zoterim te secilit prej tyre tek Digitalb, me nje vlere nominale prej 1.000 leke secili aksion (ne vijim referuar "Aksionet"), ne perputhje me dispozitat e kesaj marreveshje.

**2. Neni - Barra Sigururese dhe Detyrimet e siguruara**
**2.1** Barra siguruese qe ka vendosur cdo Barredhenes ne favor te Barremarresit, sic percaktohet ne nenin 2.3 te kesaj Marreveshje ("ne vijim referuar "barra siguruese"), siguron pagimin dhe permbushjen e te gjitha Detyrimeve te Barredhenesve dhe Digitalb ndaj Barremarresit ne perputhje me dispozitat e Marreveshjes Kuader.

**2.2** Barra siguruese do te jete e vazhdueshme deri ne kryejen e plote te pagesave si dhe permbushjen e gjithe detyrimeve te Digitalb dhe Barredhenesve ndaj Barremarresit ne perputhje me Marreveshjen Kuader.
Numri i Aksioneve qe secili prej Barredheneseve do te barresoje ne favor solidar te Barremarresve tregohet ne tabelen me poshte:

| Barredhenesi | Perqindja e pjesemarrjes ne Digitalb qe barresohet | Respektivisht, numri i aksioneve qe do te barresohen |
|---|---|---|
| Alban Jaho | 0.48% | 1,104.36 |
| Sara Hoxha | 0.53% | 1,217.98 |
| Lorela Hoxha | 0.00% | 0.00 |
| Vjollca Hoxha | 0.00% | 0.00 |
| Itan Hoxha | 1.63% | 3,754.84 |
| Redia Hoxha | 6.00% | 13,801.00 |
| Enkelejdi Joti | 0.48% | 1,104.36 |
| Petraq Shomo | 1.60% | 3,681.22 |
| Eduard Poda | 0.48% | 1,104.36 |
| Arben Taipi | 1.60% | 3,681.22 |
| UNION DISTRIBUCION SERVIS ALBANIA | 3.20% | 7,362.43 |
| **Totali:** | **16.00%** | **36,811.78** |

2.3 Pergjate gjithe kohezgjatjes se marreveshjes siguruese, Barremarresi nuk do te kete te drejte te marre dividente nga aksionet mbi te cilat eshte vendosur Barra Siguruese ne favor te tij.

**3. Neni - Kohezgjatja**

**3.1** Kjo marreveshje hyn ne fuqi menjehere me nenshkrimin e saj nga palet dhe ka afat deri ne **31.12.2019.**

**3.2** Brenda nje afati 10 ditor nga nenshkrimi i saj secili prej Barredhenesve duhet te kryeje te gjitha regjistrimet e nevojshme te Barres Sigurruese ne Regjistrin e Barreve Siguruese prane Ministrise se Financave si dhe te kryeje regjistrimet perkatese te Barres siguruese prane Regjistrit Tregtar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit si dhe t'i dorezoje Barremarresit nje kopje te certifikates se ketyre regjistrimeve.

**3.3** Barra siguruese duhet te regjistrohet ne Regjistrin e Barreve Siguruese e te qendroje i regjistruar si i tille deri ne momentin e permbushjes se te gjitha detyrimeve te Barredhenesve dhe Digitalb ndaj Barremarresit , ne perputhje me dispozitat e Marreveshjes Kuader.

**3.4** Pergjate kohes kur mbi Aksionet eshte vendosur Barra siguruese, ne rast se secili prej Barredhenesve/DGA nuk permbush detyrimet e tij ndaj Barremarresit sipas Marreveshjes Kuader, Barremarresi ka te drejte te marre ne posedim Barren siguruese perkatese ne perputhje me dispozitat e kesaj marreveshje dhe legjislacionin e fuqi per barret siguruese.

**4. Neni - Deklarime dhe garanci te Barredhenesit**

**4.1** Barredhenesi deklaron dhe garanton se eshte zoterues i ligjshem i aksioneve mbi te cilat vendoset barra siguruese(ne vijim referuar „Aksionet).

**4.2** Pervec sa parashikohet ne kete marreveshje, Barredhenesi deklaron dhe garanton Aksionet jane te lira nga cdo e drejte e paleve te treta dhe se nuk ka vendosur kolatareal apo barre tjeter sigururese mbi Aksionet

**4.3** Barredhenesi garanton se nuk ka asnje padi, veprim, procedure ekzekutimi apo paraekzekutimi te mbetur pezull ose ne porces ne lidhje me Aksionet.

**4.4** Barredhenesi deklaron dhe garanton se ka te gjitha tagrat per te vendosur kete barre sigururese mbi Aksionet.

**4.5** Pergjate kohezgjatjes se kesaj marreveshje Barredhenesi merr persiper te mos transferoje, vendose apo te lejoje vendosjen e barreve siguruese te cilat mund te ndikojne ne te drejtat dhe interesat e Barremarresit mbi Aksionet, pa miratimin me shkrim nga Barremarersi.

**4.6** Barredhenesi garanton se per interes te Barremarresit do te ndermarre te gjitha veprimet e nevojshme si dhe jep te gjitha garancite per te. Ne rast te mospermbushjes se plote ose te pjesshme te garancive te tij, Barredhenesi do te zhdemtoje barremarresin per te gjitha humbjet qe rezultojne

**4.7** Parashtrimet e specifikuara me siper, do te vazhdojne te jene te verteta deri ne perpumbushjen e plote te et gjitha detyrimeve te Digitalb dhe te Barredhenesve ndaj Barremarresit sipas Marreveshjes Kuader.

**5. Neni - Te drejtat dhe detyrimet e Barredhenesit**

**5.1** Barredhenesi nuk ka te drejte te delegoje te drejtat e detyrimet e tij ne baze te kesaj marrevshje ne pale te treta, pervec rastit kur ka marre miratimin paraprak me shkrim te barremarresit.

**5.2** Barredhenesi garanton se te drejtat e Barremarresit ne baze e zbatim te kesaj marreveshje lidhur me barren siguruese mbi Aksionet, nuk do te nderpriten apo cenohen nga Barredhenesi apo trashegimtaret e tij, perfaqesuesit e tij apo persona te tjere.

**5.3** Pas kryerjes se plote te pageses ne baze te Marreveshjes Kuader , pa miratimin paraprak me shkrim te Barremarresit per permbushjen e plote te detyrimeve te Barredhenesit ndaj Barremarresit, Barredhenesi nuk mund te cregjistroje Barren nga Regjistri i Barreve Siguruese.

**5.4** Cdo Barredhenes merr persiper te:

**5.4.1** njoftoje menjehere Barremarresin per:

- Cdo ndryshim te emrit dhe adreses dhe te te dhenave te tjera qe ka deklaruar per identifikimine tij dhe mbajtjen e Korrespondences te barredhenesit;
- Cdo ndryshim te vendit ku barredhenesi zhvillon aktivitetin e tij tregtar ose, nese Barredhenesi ka me shume se nje vend te tille te selise kryesore te Barredhenesit;
- Cdo transferim te barres ne pale te treta;
- Cdo ndryshim apo humbje te barres siguruese;
- Cdo rast mospermbushje apo pamundesi te permbushjes te detyrimeve te tij ne baze e zbatim te marreveshjes Kuader;
- Cdo marrje persiper te detyrimeve monetare ose marrje hua para ne cdo forme;
- Konstatimit te njerit prej rasteve te mospermbushjes;

**5.4.2** Se nuk do te shese, jape me qera apo tjetersoje Barren Siguruese/Kolateralin, pa pelqimin paraprak me shkrim te Barremarresit.
**5.4.3** do te beje, ekzekutoje, njohe dhe shperndaje formularet e njoftimit te regjistrimit dhe kalime te metejshme te te drejtave, trasnfertave, dokumentave, akteve duke perfshire dhe shtojca te metejshme te kesaj marreveshje sic mund te ekrkohet ne menyre te arsyeshme nga Barremarresi ne menyre qe kjo marreveshje te kete efekt.

**6. Neni - Verifikimi i Barres siguruese**
**6.1** Barremarresi do te kete ne cdo kohe te drejten te verifikoje ekzistencen dhe gjendjen e Barres Siguruese/Kolateralit ne cdo menyre qe barremarresi do ta konsideroje te pershtatshme dhe barremarresi bie dakord te ogroje gjithe asistencen dhe informacionin si dhe te kryeje te gjitha veprimet qe kane lidhje me kete sipas kerkeses se arsyeshme te Barremarresitdhe per kete qellim t'i jape Barremarresit mundesi te verifikoje Regjistrin e Aksioneve te shoqerise DigitAlb.

**7. Neni -Shpenzimet**
Barredhenesi duhet te paguaje te gjitha kostot e arsyeshme te Barremarresit, taksat dhe shpenzimet ne lidhje me pergatitjen , regjistrimin ose ndryshimin e kesaj marreveshje, plotesimin dhe depozitimin e barres siguruese, zbatimin ne cdo forme te dispozitave ose ushtrimin e te drejtave dhe mjeteve ligjor sipas Marreveshjes apo sipas legjislacionit ne fuqi per barret siguruese.

**8. Neni - Rastet e mospermbushjes**
**8.1** Cdonjera nga ngjarjet e percaktuara ne Marreveshjen Kuader si nje Rast Mospermbushje do te konsiderohet si Rast Mospermbushjeje edhe sipas kesaj Marreveshjeje.
**8.2** Digitalb, Barredhenesit dhe Barremaresit do te njoftojne njeri-tjeterin menjehere pas konstatimit apo nese vihen ne dijeni te nje Rasti Mospermbushjeje. Me konstatimin ose marrjen dijeni te nje Rasti Mospermbushjeje Barremarresit kane te drejte:
a) te kerkoje Barredhenesve pagesen e plote te te gjitha detyrimeve ne baze te Marreveshjes Kuader; dhe
b) te ndermarrin cdo veprimi tjeter qe konsiderojne te nevojshem ne permbushje te te drejtave te tyre; dhe
c) te ekzekutojne barren siguruese.

**9. Neni -Njoftimet**
Me përjashtim kur është rënë dakord ndryshe, të gjitha njoftimet dhe komunikimet që i adresohen Palëve do të bëhen me shkrim, në gjuhën shqipe dhe dorezohen ne nje prej formave ne vijim: (i) do të dorëzohen personalisht, (ii) do të dërgohet me poste rekomande, (iii) me poste elektronike (e-mail), (iv) do të dërgohet me fax të konfirmuar me postë rekomande, ose (v) do të dërgohen me kurier, në adresat e specifikuara me poshtë.
**9.1** Personat kontaktues.
Personat kontraktues jane te gjithe personat e percaktuar ne nenin 14 te Mareveshjes Kuader me te dhenat perkatese.
Keto persona me lart duhet te jene te kopjuar (CC) ne te gjithe korrespondencen midis dy paleve.

**10. Neni - Ligji i zbatueshëm dhe Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**
**10.1** Kjo Kontrate rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Per cdo ceshtje qe nuk eshte rregulluar nga kjo Kontrate, do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.
**10.2** Çdo mosmarrëveshje apo pretendim në lidhje me kete kontrate duke perfshire, por jo duke u kufizuar ne vlefshmërinë, efektivitetin, interpretimin, shkeljen e dispozitave, zbatimin e detyrimeve kontraktuale gjate dhe pas perfundimit te kesaj kontrate dhe mbarimin e kësaj kontrate do të zgjidhet përfundimish nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, duke perfshire dhe rastet kur mosmarreveshja apo pretendimi ka baza te tjera ligjore, te ndryshme nga kontrata

**11. Neni- Marreveshja ne teresi dhe ndryshimet**

**11.1** Kjo Kontratë përbën Marrëveshjen në tërësi dhe shfuqizon çdo marrëveshje të mëparshme me goje ose me shkrim, përfshirë edhe anekset e këtyre marrëveshjeve ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontratë.

**11.2** Kjo marrevshje do te jete e detyrueshme per Barredhenesit dhe per pasardhesit e tij dhe ne favor te Barremarresit dhe pasasrdhesve te tij.

**11.3** Kjo marreveshje eshte e transferueshme(cedueshme) nga Barremarresi dhe Barredhenesi nuk ka te drejte t'i kundervihet cesionarit apo te ngreje pretendimet qe ai ka ndaj Barremarresit.

**11.4** Çfarëdo ndryshimi i kësaj Kontrate do të bëhet me shkrim dhe me pajtim paraprak të dy palëve, dhe do t'i referohet në mënyrë specifike kësaj Kontratë.

**11.5** Kjo Kontratë hartohet ne 4 (kater) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, me permbajtje te njejte dhe pasi lexohet dje palet shprehen se perputhet me vullnetin e plote te tyre, neshkruhet prej tyre ne pranine time.

**P A L Ë T**

**BARREDHENESI**

**Alban Jaho**

**Sara Hoxha**

**Itan Hoxha**

**Redia Hoxha**

**Enkelejdi Joti**

**Eduart Poda**

**Per Union Distribucion Servis Albania" sh.p.k**
**perfaqesuar nga Ilir KARAGUNI**

**Për: "DEM CAPITAL" SH.P.K**
**Petraq SHOMO**

**Për : "E& E Investmet" SH.P.K**
**Arben TAIPI**

**Pale prezente:**

**Vjollca HOXHA**

**Lorela HOXHA**

**BARREMARRESI**

**Saimir Mane**

**Shoqeria "Aiba Kompani" SH.A**

**Alba GINA**

**Agim ZEQO**

**N O T E R I**

1. Redia Hoxha, shtetase shqiptare, minorene nen pergjegjesine e vetme prinderore te nenes se saj Znj. Vjollca Hoxha, mbajtese e pasaportes me numer BB8082295, e cila ne perputhje me nenin 232 dhe 233 te Ligjit nr 9062 per Kodin e Familjes perfaqesohet plotesisht nga Znj. Vjollca Hoxha; dhe
2. Itan Hoxha, shtetas shqiptare, minoren nen pergjegjesine e vetme prinderore te nenes se saj Znj. Vjollca Hoxha, mbajtes i pasaportes me numer BB8082282, e cili ne perputhje me nenin 232 dhe 233 te Ligjit nr 9062 per Kodin e Familjes perfaqesohet plotesisht nga Znj. Vjollca Hoxha.
3. zArben Taipi si Administratori i Shoqerise "E&E Investmet" sh.p.k perfaqesohet me prokuren nr.1196 Rep dhe 739 Kol date 29.10.2015 nga z.Petraq Shomo.

**V E N D I M**

**I**

**ASAMBLESE SE PERGJITHESHME**

**Nr.__4__ Datë _04/12/2019_**

Sot, më datë **04/12/2019** në orën 16:50 në selinë e shoqërisë "Digit-Alb" sh.a me adrese: rruga "Pavarësia" nr.39, Kashar, Tiranë, u mblodh Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, në zbatim të nenit 136 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përputhje me statutin e shoqërisë.

Shoqëria Digit-Alb **e zoteruar nga aksionaret si me poshte vijon:**

**Z. Itan Hoxha**, zoterues i **10,19 %** te kapitalit aksionar te DIGITALB;

**Z. Enkelejdi Joti**, zoterues i **3 %** te kapitalit aksionar te DIGITALB;

**Z. Eduard Poda**, zoterues i **2 %** te kapitalit aksionar te DIGITALB;

**Z. Redia Hoxha**, zoterues i **10,19 %** te kapitalit aksionar te DIGITALB;

**Shoqëria "DEM Capital"**, zoteruese e **10.5 %** te kapitalit aksionar te DIGITALB;

**Shoqëria "E&E INVESTMENT"**, zoteruese e **10.5 %** te kapitalit aksionar te DIGITALB;

**UNION DISTRIBUCION SERVIS ALBANIA**, zoteruese e **10 %** te kapitalit aksionar te DIGITALB;

**UNION GROUP SHPK**, zoteruese e **10 %** te kapitalit aksionar te DIGITALB;

**LORESA**, zoteruese e **30,60%** te kapitalit aksionar te DIGITALB;

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme ka për rend dite:

1. Diskutim mbi **Raportin Konfidencial** te pergatitur ne lidhje me **Marreveshjen Kuader Nr. 684 Rep dhe Nr.102 Kol te dates 10.03.2010,** ndryshuar me aktin noterial **Nr.4847 Rep dhe Nr. 2736 Kol, date 18.12.2015, "Per disa ndryshime ne Marreveshjen Kuader Nr. 684 Rep dhe Nr.102 Kol, date 10.03.2010,** lidhur ndermjet ish aksionereve te shoqerise **"Supersport"** sha, shoqerise **"Digitalb" sha,** si dhe te gjithe aksionere te shoqerise **"Digitalb" sha,**
2. Diskutim ne lidhje me zgjidhjet e mundshme mbi rregullimin e pasojave qe kane krijuar **Marreveshja Kuader Nr. 684 Rep dhe Nr.102 Kol te dates 10.03.2010,** ndryshuar me aktin noterial **Nr.4847 Rep dhe Nr. 2736 Kol, date 18.12.2015** si dhe **Akt-Marreveshjet e dates 18.12.2015.**

Konstatohet se:

- aksioneret e DIGITALB jane njoftuar ne menyre te rregullt per mbledhjen dhe per rendin e dites, ne perputhje me Statutin;

- kuorumi per te cilesuar mbledhjen si te vlefshme me qellim marrjen e vendimeve per rendin e dites eshte i permbushur ne perputhje me Statutin;

- pjesemarresit kane autoritetin dhe fuqine e nevojshme per te marre pjese ne mbledhje dhe per te nenshkruar vendimin ne perputhje me Statutin;

- rezulton se nuk është i pranishëm ne mbledhje aksionari shoqëria "E&E Investment";

- rezulton se aksionarët:
  **Enkelejdi Joti** (ishte i pranishëm por nuk mori pjesë në votim);
  **Eduard Poda** (ishte i pranishëm por nuk mori pjesë në votim);
  **DEM Capital** (ishte i pranishëm por nuk mori pjesë në votim);
  **UNION DISTRIBUCION SERVIS ALBANIA** (ishte i pranishëm por nuk mori pjesë në votim);
  **UNION GROUP** (ishte i pranishëm por nuk mori pjesë në votim);

**PER SA ME SIPER**

Aksionerët e pranishëm dhe të përfaqësuar te shoqerise **"Digitalb"** pasi diskutuan mbi ceshtjen e rendin e dites te sipercituar duke konluduar se **Marreveshja Kuader Nr. 684 Rep dhe Nr.102 Kol te dates 10.03.2010,** ndryshuar me aktin noterial **Nr.4847 Rep dhe Nr. 2736 Kol, date 18.12.2015, "Per disa ndryshime ne Marreveshjen Kuader Nr. 684 Rep dhe Nr.102 Kol, date 10.03.2010"**, e lidhur ndermjet **aksionereve te shoqerise "Supersport"** sha, me Nipt Nr. K62031001W, **shoqerise "Digitalb" sha,** me Nipt Nr. Nr. K41719004D si dhe te **gjithe aksionere te shoqerise "Digitalb" sha**, jane nje akte te lidhura ne dem te shoqerise **"Digitalb"** sha, dhe te aksionereve te **"Digitalb"**, ne perfundim te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme, mbeshtetur ne Nenin 135 te Ligji per Shoqerite ne Shqiperi dhe te Statutit te DIGITALB;

Në përfundim të mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme, pasi u diskutua rendi i dites, mbështetur në nenin 135 te ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" dhe të Statutit e Shoqërisë "DigitAlb" sh.a, Asambleja e Pergjithshme e Shoqërisë.

**VENDOSI:**

**1.** Mos pagimin nga ana e shoqerise **"Digitalb"** te kesteve te mbetura te cmimit te blerjes dhe riblerjes te aksioneve te shoqerise **"Supersport"** kundrejt ish aksionereve te shoqerise **"Supersport"** apo personave qe ju jane kaluar te drejtat sipas **Marreveshjes Kuader Nr. 684 Rep dhe Nr.102 Kol, date 10.03.2010,** ndryshuar me aktin noterial Nr.4847 Rep dhe Nr. 2736 Kol, date 18.12.2015, **"Per disa ndryshime ne Marreveshjen Kuader Nr. 684 Rep dhe Nr.102 Kol, date 10.03.2010.**

2. Refuzimin e shitjes me kusht te aksioneve ne shoqerine **"Digitalb"** ish aksioneve te shoqerise **"Supersport"** apo personave qe ju jane kaluar te drejtat, te cilet nuk jane aksionere te shoqerise **"Digitalb" sha,** sipas **Marreveshjes Kuader Nr. 684 Rep dhe Nr.102 Kol, date 10.03.2010,** ndryshuar me aktin noterial Nr.4847 Rep dhe Nr. 2736 Kol, date 18.12.2015, **"Per disa ndryshime ne Marreveshjen Kuader Nr. 684 Rep dhe Nr.102 Kol, date 10.03.2010.**

3. Ti kerkohet ish aksionereve te shoqerise **"Supersport"**, te heqin barren siguruese mbi aksionet e aksionereve te shoqerise **"Digitalb"** vendosur mbi baze te **Marreveshjes Siguruese"** Nr 4848 Rep dhe Nr 2737 Kol e dates 18.12.2015.

4. Ti kerkohet Qendres Kombetare te Biznesit te refuzoje cdo regjistrim te aplikimit per ndryshimin e te dhenave mbi aksioneret e shoqerine **"Digitalb"** si dhe te përqindjes se pjesëmarrjes se aksioneve ne shoqerine **Digitalb"** sha, pa nje akt, kontrate transferimi, shitje aksionesh, por vetem bazuar ne **Marreveshjen Kuader Nr. 684 Rep dhe Nr.102 Kol, date 10.03.2010,** ndryshuar me aktin noterial Nr.4847 Rep dhe Nr. 2736 Kol, date 18.12.2015, **"Per disa ndryshime ne Marreveshjen Kuader Nr. 684 Rep dhe Nr.102 Kol, date 10.03.2010,** pasi si **Marreveshja Kuader** dhe ndryshimi i saj me aktin noterial Nr.4847 Rep dhe Nr. 2736 Kol, date 18.12.2015, jane akte qe nuk plotesojne kushtet e regjistrimit percaktuara nga neni 54 i ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007" Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

5. Ngarkohet administratori i shoqerine **"DigitAlb"** per zbatimin e ketij vendimi.

Per sa me siper, ky vendim eshte hartuar dhe i eshte lexuar te gjithe aksionarëve pjesëmarres ose te përfaqësuar në mbledhje, të cilët kanë rënë dakort me vullnetin e tyre të lirë dhe nenshkruajnë si më poshtë:

**AKSIONERI /AKSIONERET**
**Shoqëria Digit-Alb SH.A**
**Përfaqësuar nga:**

**Z. Itan HOXHA** (perfaqesuar nga Ilir Dode me autorizim)

Ilir Dode

**Z. Redia HOXHA** (perfaqesuar nga Ilir Dode me autorizim)

Ilir Dode

**Z. Enkelejdi JOTI** **Z. Eduard PODA**



PLATFORMË TELEVIZIVE DIXHITALE TOKËSORE DHE SATELITORE • DigitAlb • info@digitalb.tv • www.digitalb.al

**DEM Capital**
**Administratori Petraq Shomo**

**E&E Investment**
**Administratori Arben Taipi**

**UNION DISTRIBUCION SERVIS ALBANIA**
**Administratori Ilir Karaguni**

**UNION GROUP SHPK**
**Administratori Niko Leka**

**LORESA SHPK**
**Administratori Lorela Hoxha** (perfaqesuar nga Ilir Dode me autorizim)

Ilir Dode

PLATFORMË TELEVIZIVE DIXHITALE TOKËSORE DHE SATELITORE
DigitAlb
info@digitalb.al www.digitalb.al